

VENDIM
Nr.1044, datë 22.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR LEVAN - TEPELENË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan - Tepelenë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 24 274 (njëzet e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër) m² tokë arë, me vlerë 5 243 618 (pesë milionë e dyqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, për sipërfaqen truall 3 615 (tre mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) m², me vlerë 648 382 (gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë, për kullotë, me sipërfaqe 15 488 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) m² me vlerë 1 564 288 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, për objekte me vlerë 3 879 913 (tre milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 11 336 201 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 11 336 201 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e një) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë më 30.12.2010 dhe të përfundojë më 30.5.2011.

6. Pronarët e përmendur në listat që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

8. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tepelenë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tepelenë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tepelenë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha